



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 884/1 Prot.

Tiranë, më 9.2.2022

U D H Ë Z I M

Nr. 2, datë 9.2.2022

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 28.01.2020, "PËR  
PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË  
DREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2020, "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:
  - a. Titulli i udhëzimit ndryshon si më poshtë:  
*"Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar"*
  - b. Shkronja b), e pikës 1, të Kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:  
*"b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësim jo më pak se "Mirë", në kualifikimin e fundit;"*
  - c. Shkronja d), e pikës 1, të Kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:  
*"d) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë."*
  - d. Shkronja e), e pikës 2, të Kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:  
*"e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor;"*
  - e. Titulli i Kreut II, ndryshon si më poshtë:

*“Mbarimi i marrëdhënies së punës, ulja në detyrë, pezullimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*

f. Shkronja a), e Kreut II/A, ndryshon me këtë përmbajtje:  
*“a) jep dorëheqjen, për arsye personale ose kur nuk pranohet për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar apo nuk certifikohet deri në 2 testime të njëpasnjëshme pas përfundimit të tij;”.*

g. Pas pikës A, shtohet pika A.1 me këtë përmbajtje:

*“A.1. Raste të ujes në detyrë të drejtorit të IPAP”*

*Drejtori i IPAP, i nënshtrohet procedurës së vlerësimit vjetor të performancës, nga ana e ZVAP. Në rast se pas vlerësimit vjetor drejtori rezulton me performancë jo të kënaqshme, ndaj tij merret masa disiplinore e uljes në detyrë nga DRAP dhe kalim në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt brenda të njëjtit ZVAP”.*

h. Shkronja g), e pikës 1, të Kreun II/B, ndryshon si më poshtë:  
*“IPAP që ai drejton ka dy vlerësime të njëpasnjëshme “Dobët.”.*

i. Shkronja j), e pikës 1, të Kreut II/B, shfuqizohet.

j. Në Kreun III, pas pikës 1 shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:  
*“1.1 Kandidati fitues për drejtor të IPAP, i cili nuk është certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, emërohet përkohësisht nga drejtori i DRAP deri në certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve, pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi.”.*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

MINISTËR

Evis KUSHI

